

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Tiranë, më 09.04.2015

Nr. 176 Prot.

Lënda: Përcillet qëndrimi i Këshillit të Fakulteti të Shkencave të Natyrës për projektligjin "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit te larte në Republikën e Shqipërisë", të miratuar në mbledhjen e qeverisë.

REKTORATIT

Këshilli i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në mbledhjen e zhvilluar sot në datën 09.04.2015, ndër të tjera diskutoi dhe për projektligjin "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit te larte në Republikën e Shqipërisë", të miratuar në mbledhjen e qeverisë.

Mbas diskutimeve për këtë projketligj, për kapitullin XII "Institucioni publik i pavarur i arsimit te lartë" u vendos unanimisht nga ky Këshill që t'i propozohet Senatit të Universitetit të Tiranës heqja e këtij kapitulli, pasi bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me zhvillimin aktual të sistemit arsimor në Shqipëri.

Gjithashtu në këtë mbledhje u vendos që t'i propozohet Senatit të Universitetit të Tiranës të shkohet mundësia e përfshirjes së stafit ndihmës mësimor në procesin zgjedhor për strukturat përkatëse.

Bashkëngjitur keni Vendimin e KF nr. 7, datë 09.04.2015.

DEKANI

MYNYR KONI





UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
KËSHILLI I FAKULTETIT

VENDIM

Nr. 7, datë 09.04.2015

"Për qëndrimin ndaj projektligjit "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të miratuar në mbledhjen e qeverisë

Këshilli i Fakultetit i mbledhur më datë 09.04.2015, pasi analizoi projektligjin "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të miratuar në mbledhjen e qeverisë,

VENDOSI:

1. Heqjen e Kapitullit XII "Institucioni publik i pavarur i arsimit të lartë" nga ky projektligj, pasi bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me zhvillimin aktual të sistemit arsimor në Shqipëri.
2. T'i propozojë Senatit të UT-ës të ndërmjetësojë me strukturat parlamentare për heqjen e këtij kapitulli.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
MYNYR KONI



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

Rruga Milto Tutulani , Albania, Tel +355 4 2230369

Nr. 337 Prot

Tiranë, më 09/04/2015

Lënda: Dërgohet Vendimi i Këshillit të Fakultetit të Shkencave Sociale për draft-ligjin për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”

Drejtuar: **REKTORATIT TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Bashkëlidhur po Ju dërgojmë Vendimin Nr. 4, datë 08.04.2015, të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Sociale, lidhur me qëndrimin mbi draft-ligjin për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”.





**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE**

Bulevardi "Gjergj Fishta", Tirana, Tel +355 4 22 30 369

V E N D I M

NR. 4 Dt. 08/04/2015

Këshilli i FSHS i mbledhur sot më datën 08.04.2015 diskutoi lidhur me draftin e ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor. Pas diskutimesh lidhur me problemet që ka miratimi i këtij drafti lidhur me arsimin publik,


VENDOSI:

Këshilli i FSHS është kundër krijimit të institucionit publik të pavarur, si një institucion hibrid i cili do të mundësojë rrënimin e universiteteve publike për arsyet e rradhitura më poshtë:

- Ky institucion hibrid bën të mundur transferimin indirekt të parave publike drejt institacioneve private të konvertuara në publike të pavarura;
- Nëpërmjet këtij institucioni hibrid universitetet publike ekzistuese përfshihen në një konkurencë tërësisht të pabarabartë me universitetet private të konvertuara në publike të pavarura dhe si pasojë në të ardhmen e afërmë do të rruhen deri në rrënimin e plotë të tyre;
- Statusi i barabartë i institacioneve publike dhe publike të pavarura të arsimit të lartë dhe konkurrimi për paratë publike do të çojë në rritjen disporpropionale të tarifave të studimit në universitet publike duke privuar potencialisht nga e drejta e studimit studentët me më pak të ardhura.

Këshilli FSHS mbështet reformimin e institacioneve të arsimit të lartë, por është për një ndarje të qartë të institacioneve të arsimit të lartë publik dhe privat.

KRYETARISI KËSHILLIT TË FAKULTETIT





Tiranë, më 10.03.2015

Nr 366 / Prot

Lënda: Dërgohen sugjerime për draftin e ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë

REKTORIT TË UT-së

Z.Dhori KULE

Z.Rektor,

Në përbushje të detyrimit akademik e me vullnetin e mirë për të ndihmuar në përmirësimin e ligjit të Arsimit të Lartë, po Ju dërgojmë sugjerimet e Këshillit të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, të cilat janë përcjellë edhe pranë grupit të punës për hartimin e këtij drafti.

DEKANI

Shezai RRÖKAJ



MENDIME TË KËSHILLIT TË FAKULTETIT TË HISTORISË DHE TË FILOLOGJISË TË UT- së MBI DRAFTIN E LIGJIT PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË


Krahasuar me draftin e mëparshëm, në këtë draft të ri të dërguar për diskutim, vërejmë se janë bërë disa ndryshime të pjesëshme si: shndërrimi konceptual i Arsimit të Lartë nga shërbim publik në të mirë publike, zhvendosja e aplikimeve nga QSHA në universitete, ekuilibrimi deri në një farë shkalle i marëdhënieve mes Senatit dhe Bordit të Administrimit, rregullimi i marëdhënieve mes autoriteteve universitare, kompetencave të institucioneve të Ministrit dhe të Presidentit, përfshirja e studentëve në zgjedhjen e autoriteteve universitare.

Por vërejmë se ka edhe mjaft nene të draftit, të cilat, nuk rezulton të janë përmirësuar sipas propozimeve të bëra nga ana jonë. Me synimin që ky draft të përmirësohet, në pritshmëri të grupeve të interesit dhe në përafërim me ligjet e arsimit të lartë të vendeve ku vendi ynë aspiron të integrohet, Këshilli i Fakultetit të Historisë e Filologjisë, sugjeron si vijon:

1. Modeli i fuksionimit dhe i manaxhimit që paraqet ky ligj, nuk rezulton të jetë i ngjashëm me asnje nga përvojat e vendeve evropiane të kodifikuara në ligjet e arsimit të lartë. Ne gjykojmë se përvoja e tyre garanton më shumë siguri dhe cilësi për arsimin e lartë se sa mdjekja e të ashtuquajturave rrugë të pashkelura.
2. Duke marrë parasysh masën e financimit aktual të arsimit të lartë, strukturat e propozuara në draft krijojnë një burokraci të rënduar dhe kosto të lartë financiare, që do të ulte mjaft financat e vet universiteve, të cilat, edhe pa ato struktura kanë qenë mjaft modeste. Ministria e Arsimit të marrë përgjegjësitë që i takojnë me kushtetutë dhe të mos krijohen struktura të mbivendosura, me kosto të larta financiare.
3. Lidhur me financimin e institucioneve të larta publike, shteti duhet të garantojë me ligj financimin bazë të tyre, ku përfshihen: fondi i pagave, grantet për kërkim shkencor dhe investimet kapitale. Neni 3, pika 2, tregon qartë devijimin nga detyrimi bazë mbi funksionimin e IAL-ve publike dhe paradoksalisht vetfinancimi – si rrugë për sigurimin e fondeve, del në plan të parë.
4. Agjensia e Sigurimit të Cilësisë (ASCAL), në draft mbetet e varur drejtëpdrejt nga qeveria, ndërkohë që i jepen kompetenca pavarësie deri në përcaktimin e fondit bazë në varësi të rankimit. Kjo me të drejtë në shumë vende nuk shkon më shumë se 10% e fondit të financimit total. Duhet të jetë e përcaktuar qartazi pavarësia e saj, duke filluar nga emërimi i drejtorit dhe anëtarëve të bordit të saj, që ne propozojmë të bëhet nga parlamenti. Po kështu, ekspertët që do të vlerësojnë IAL, propozojmë të janë të huaj dhe shumica e bordit të jetë po me anëtarë të huaj, për të garantuar një objektivitet sa më të sigurt në vlerësim.

5. Kreu XII ngjan si shtojcë në draftin e Arsimit të Lartë, pasi nuk krijon lidhje organike me tërësinë e ligjit. Nga përvoja e drafteve të shumë universiteve homologe, nuk rezulton një format i tillë (*universitete publike të pavarura*), prandaj propozojmë të mos përfshihet ky emërtim në ligj.
6. Gjithë fryma e ligjit synon të ndërtojë, nga njëra anë një raport autonomie dhe varësie mes institucioneve të shtetit dhe IAL-ve publike, kurse për universitetet jo publike, gjithçshka lihet të rregullohet me statutet e tyre. Kjo situatë krijon kushte pabarazie e favorizuese të padrejtë të tyre në raport me ligjin.
7. Lidhur me marëdhëniet bord-senat, propozojmë që shumica e anëtarëve të Bordit të jenë nga IAL dhe vendimet në këtë Bord të merren me shumicë të thjeshtë. Për çështje të rëndësishme si: miratimi i buxhetit, miratimi i statutit dhe rregullores, të merret miratimi Senat-Bord sëbashku, ashtu sikundër parashikohet në draft për miratimin e planit strategjik.
8. Asambleja e Pedagogëve mbetet një strukturë jofunksionale. Ajo mund të mbetet vetëm në rregulloren e zgjedhjeve dhe në vend të saj mendojmë se duhet patjetër të vihet Këshilli i Fakultetit, si një strukturë kolegjiale ndërdepartamentore, e cila bën lidhjen me strukturat superiore në Rektorat.
9. Nisur nga rëndësia që kanë sugjerimet e bëra, Këshilli i Fakultetit shpreh bindjen se ato do të trajtohen me seriozitetin e duhur nga grupei hartues i draftit.

KRYETARI I KËSHILLIT


Shezai RROKA



RRUGA "ELBASANI" TIRANE

Tel/Fax ++355 4 2452610

Prot. 668

Tiranë, 17.04. 2015

Lënda: Relacion i Këshillit të Fakultetit të gjuhëve të huaja

REKTORATIT TË UT-së

RELACION

Në mbledhjen e tij të datës 07.04.2015, Këshilli i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja diskutoi sërisht mbi Projektligjin e Arsimit të Lartë, variantin përfundimtar.

Stafi akademik i FGJH ka qenë i përkushtuar dhe është angazhuar seriozisht për të dhënë mendime dhe sugjerime, të cilat janë përcjellë më herët në formë relaciioni pranë Senatit të Universitetit të Tiranës.

Edhe në mbledhjen e fundit u diskutua me shumë përgjegjshmëri dhe seriozitet. Edhe pas dy takimeve të fundit të bëra me grupin hartues të Projektligjit, vihet re se nuk janë marrë parasysh disa sugjerime, të cilat po i përcjellim sërisht.

1. Lidhur me llojet e Institucioneve të Arsimit të Lartë:

Këshilli i Fakultetit të Gjuhëve të huaja kundërshton:

Neni 16: të hiqet "publike të pavarura"; të hiqet pikë 4

Kreu XII

Argumentim

Referuar modeleve të disa vendeve të Evropës (bashkëngjitur shkresës) dhe përvojës së shumë prej pedagogëve rezulton se “Institucioni publik i pavarur” nuk figuron në llojet e institucioneve të arsimit të lartë. Nëse ka një model të tillë institacioni, që ka pasur sukses, të na paraqitet një relacion shpjegues. Gjykojmë se Shqipëria nuk ka lluksin të bëjë eksperimente. Në vitet e stërzgjatura të tranzicionit është eksperimentuar mjaft me shkollën dhe sot kemi trashëguar një sistem shkollor jo kompetitiv dhe me mjfat probleme, probleme të cilat janë mbartur edhe në sistemin universitar.

Shqipëria ka nevojë për një Ligj të arsimit të lartë me vizion të qartë që do t'i shërbejë ringritjes së vlerave cilësore të edukimit.

2. Lidhur me pranimin në Ciklin e parë të studimeve:

Këshilli i Fakultetit kundërshton **Nenin 73, pika 1** dhe propozon rishkrimin e nenit si vijon: “Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm”. Po në **nenin 73, pika 2**, propozojmë të rishkruhet si vijon: “Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në Statutet e tyre kriteret e pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen nga institucionet e arsimit të lartë dhe vihen në dispozicion të QSHA-së dhe Ministrisë përgjegjëse për arsimin.”

Argumentim

Gjykojmë se vendosja e pragut të notës, cënon Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, autonominë akademike dhe institucionale të Institucioneve të arsimit të lartë si dhe të drejtat e njeriut për arsimim. Institucionet e arsimit të lartë duhet të përcaktojnë vetë kriteret e pranimit dhe të përzgjdhjes së kandidatëve në arsimin e lartë.

3. Lidhur me pagën e pedagogëve

Këshilli i Fakultetit gjykon se paga e pedagogëve duhet të jetë e siguruar me ligj. Në asnjë nen të projektligjit nuk citohet se Qeveria, apo Ministria e linjës, siguron pagat e stafit akademik. Tre llojet e granteve, në mënyrën sesi është konceptuar në projektligj, nuk sigurojnë pagën e pedagogëve. Kjo do të kërkonte edhe përcaktimin me Ligj të Statusit të pedagogut. P.sh. në Francë apo dhe në Itali “pedagogu është funksionar shteti” Sugjerojmë që në Ligj të përcaktohet Statusi i pedagogut.

Kryetare e Këshillit të FGJH

Prof.Dr. Klodeta Dibra





Nr. 443 Prot.

Tiranë, më 06/04/2015

Lënda: Për diskutim në mbledhjen e Senatit Akademik.

REKTORATIT UT

Fakulteti i Ekonomisë, mbështetur në diskutimet në Dekanat dhe Vendimin nr. 1, dt. 29.01.2015, të Këshillit të Fakultetit, mbi Projekt Ligjin "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë", doli në sugjerimet e mëposhtme:

1. Në variantin e miratuar nga KM, megjithëse një pjesë e vërejtjeve janë marrë parasysh, shfaqen ende problematika dhe në mënyrë të veçantë problemi kryesor ngelet Kreu XII-të "Institucioni Publik i Pavaruar i Arsimit të Lartë".
2. Kreu XII-të është kontestuar dhe kontestohej, për shkak se **nuk mbështetet në praktikat dhe përvojat e universiteteve perëndimore, është i paqartë pse duhet të kriohet, për rezultatet që sjell, si funksionon dhe si kontribuon në rritjen e burimeve të financimit dhe përdorimit të fondeve publike.**
3. Në variantin aktual të këtij kreu, i cili në procesin e gjatë të miratimit të Projekt Ligjit ka ndryshuar disa herë në mënyrë thelbësore, nuk thuhet asgjë lidhur me statusin e institucioneve private (jo publike) të Arsimit të Lartë, ndaj fondeve publike dhe ndaj rregullave për fondet që gjenerohen me trafiat e vendosura prej tyre, të cilat nuk kanë kufi të sipërm.
4. Si përfundim, opnioni i FE-së është, se këto institucione (IALPP) nuk përfaqësojnë as ndonjë përvojë ndërkombëtare, as prirjen e ndyshimit të Universiteve Eoropiane dhe Anglo-Saksone, as ndonjë nevojë të sistemit tonë arsimor (e cila nuk argumentohet në asnjë rast), as koncept të kuptueshëm për natyrën e tyre, as në parim dhe aq më pak çfarë përfiton Arsimi Lartë në Shqipëri në Termat e Standardeve dhe Cilësisë.



Dekani

Sulën HADERI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTESISE



Rruga "Milto TUTULANI ", Tirana , ALBANIA Tel Fax. + 355 4 222 537, http://www.fd-ut.edu.al

Nr. 346 / Prot.
3

Tiranë, më 23.03.2015

Lënda: Percillet qendrimi i Keshillit te Fakultetit te Drejtesise te UT-se

Drejtuar: Rektorit te UT – se, Prof.Dr. Dhori KULE

I nderuar zoti Rektor,

Në mbledhjen e tij të datës 20.03.2015, Këshilli i Fakultetit të Drejtësisë UT, diskutoi mbi verejtjet e bera nga grapi i punes i ngritur per te analizuar versionin e fundit te projekt-ligjit "Per Arsimin e Larte ne RSH", specifisht kreun XII te tij. Pasi u njoh me analizen e grupit te punes mbi kete kre, Këshilli i vleresoi shume te drejta observacionet perkatese dhe vendosi unanimisht te miratoje qendrimin e grupit te punes dhe tia percjelle ate strukturave te Rektoratit te UT – se per informim e veprim. Bashkengjitur observacionet perkatese te miratuara. versoni i miratuar. Këshilli e vleresoi ate si shume te drejte.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj të plotë, ju falënderojmë për bashkëpunimin.

DEKANI
Prof. Dr. Altin SHEGANI

KOMENTE SHTESË NË LIDHJE ME KREUN XII TË PROJEKTIGJIT PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në kreun 12 të projektligjit është parashikuar krijimi i Institucioneve Publik të Pavarura të Arsimit të Lartë. Këtë kre e konsiderojmë si problematikë në disa drejtime të cilat po i shtjellojmë në vijim.

Kështu, siç është vlerësuar nga Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Raportin Përfundimtar për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, ndryshimi i statusit të IAL-ve “nga institucione autonome në institucione të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre”, që është parashikuar në kreun XII të draftit final të ligjit, do të kërkonte “ndryshime të mëtejshme ligjore dhe, pa dyshim, edhe ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”¹

Si rrjedhim, do të ishte e nevojshme që fillimisht të diskutoheshin ndryshimet në nivel kushtetues dhe më pas të mund të diskutohej mbi shtesat në ligj.

Vetë Kushtetuta përdor termin “autonomi” kur i referohet IAL-ve (neni 57/7), ndërsa ligji i ri propozohet të përdorë termin “pavarësi” përmes krijimit të konceptit të ri të Institucioneve të pavarura publike/institucioneve publike të pavarura. Nga ana tjetër, edhe vetë Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, kur i referohet statusit të ri të IAL-ve thekson se ato garantojnë “autonominë e plotë” të IAL-ve.²

Gjithashtu, do të ishte e nevojshme që më pare të sigurohej se “njehsimi” i statuse vetë IAL-venë Shqipëri, i cili është paraqitur si një objktivi fazës së dytë afat gjatë të reformimit, nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën, pasi sikurse e ka pranuar Komisioni në Raportin e lartpërmendur “institucionet e arsimit të lartë nuk mund të kthehen të gjitha në fondacione, bazuar në ligjin dhe Kushtetutën e RSH-së”³.

Nga ana tjetër ky kre nuk sqaron se cili është qëllimi i krijimit të qëllimit të këtyre institucionëve dhe çfarë statusi do të kenë ato. Në lidhje me IALPP ligjit i mungon qartësimi i qëllimit për të cilin ato krijohen dhe çfarë të reje do të orfojnë këto institucionë në raport me mësimdhënien në arsimin e lartë.

Projektligji nuk ka përcaktuar formën e organizimit të këtyre institucionëve nëse do të organizohen si ente publike, si shoqëri tregtare apo si organizata joftimprurëse. Në nenin 123 të projektligjit thuhet se këto institucionë nuk ndjekin rregullat e prokurimit publik. Me këtë nënkuptoher që këto institucionë nuk do të kenë statusin e institucionëve publike, por do të janë private pa përcaktuar konkretisht se pse një institucion privat dhe pa sepcifikuar formën specifike të organizimit të tyre. Sërisht mbetet e paqartë nga dallon IAL jopublike nga IALPP.

¹Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, *Raporti Përfundimtar për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor*, Tiranë, Korrik 2014, f.61.

² Po aty, f.60.

³ Po aty.

Duke parë riorganizimin e tyre dhe mënyrën e përdorimit të pasurisë dhe burimeve të financimit rezulton se këto IALPP janë të ngjashme me organizatat jofitimprurëse. Ky lloj organizimi në këtë forme bie në kundërshtim me misionin që kanë IAL për arsimimin e lartë të brezave të rinj. Nuk mundet kurrsesi që një OJF të realizojë një mision të tillë. Edhe nëse do të aludonim se këto do të janë ente publike, në bazë të ligjeve në fuqi, entet publike duhet të krijohen me ligj, ndërkohe që në këtë kre është përcaktuar që shdnërrimi bëhet me VKM. Sipas ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për organizimin dhe funksionimin e enteve publike dhe organeve kolegiale", entet publike krijohen vetëm me ligj dhe funksionojnë si struktura jo shtetërore. Në këtë kuptim, nëse Kuvendi do të ketë vullnetin për të krijuar ente publike që ofrojnë shërbim në fushën e arsimit të lartë, atëherë ky vullnet do të shprehet rast pas rasti (siç ndodh prej vitesh në praktikën tonë legislative për krijimin e enteve publike).

Lidhur me Bordin e Administrimit, neni 122 përcakton se bordi i IALPP prej 7 anëtarësh do të ketë 3 anëtare nga themeluesi dhe 1 anëtar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Duke qenë se për IAL publike themelues është shteti atëherë rezulton se shumica e këtij bordi emërohet nga qeveria. Në këtë pikë nuk mundet që të flitet me për pavarësi. Për më tepër është e paqartë në projektligj se si do të ndryshojë mënyra e financimit të IALPP (dhe për rrjetet e edhe e përbërjes së bordit) kur shumicën e kanë përfaqësuesit e KM. Në këtë pikë ngrihet një dyshim i fortë nëse shumica e bordit do të lejojë ndryshimin e mënyrës së financimit të IALPP.

Në këtë drejtim projektligji është diskriminues në raport me IALPP që krijohen nga IAL jo publike, pasi mënyra e formimit të bordit është e ndryshme dhe ata kanë pavarësi të plotë në raport me IALPP që krijohen nga IAL publike.

Për më tepër dispozitat e këtij kreu nuk rregullojnë procedurën e inspektimit që ka të drejtë të ushtrojë ministria e arsimit.

Duke qenë se keto IAL janë të "pavarura", atëherë ministria dhe Këshilli i Ministrave nuk mundet që të pretendojnë kompetenca të pakushtëzuara kontrolli. Për më tepër përbën një nonsens juridik fakti që Këshilli i Ministrave ka të drejten të pezullojë apo të mbyllë një institucion të "pavarur", i cili ka personalitet juridik të pavarur dhe të veçantë.

Për arsyet e mësipërme jemi të mendimit se në Shqipëri nuk ka nevojë për krijimin e IALPP pasi arsimi i lartë publik në të gjithë keto vite në vendin tonë, është ofruar nga IAL publike dhe jo publike dhe asnjëherë nuk ka lindur nevoja për krijimin e strukturave hibride të këtij lloji.